

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-43/12

Prishtinë, 10 dhjetor 2013

Në çështjen juridike të:

P.I

Ankuesi

kundër

B.M

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-ës i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/83/2010 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA17887), i datës 2 shtator 2010, pas seancës së mbajtur me 10 dhjetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet si e palejueshme ankesa e P.I për shkak të mungesës së interesit juridik.**

Me datë 17 nëntor 2011 A.I ka paraqitur një ankesë kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/83/2010, i datës 2 shtator 2010, në pjesën që ka të bëjë me lëndën të regjistruar me numër KPA17887. Ankesë sipas numrit rëndor të lëndës 220/2011 është shqyrtuar nga gjykata.

Me lëshimin e Gjykatës ankesat nuk janë shqyrtuar bashkarisht.

Me 4 qershor 2012 Kolegji i Apelit të AKP-ës me vendimin numër 220/11 ka anuluar vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/83/2010, i datës 2 shtator 2010, në pjesën që ka të bëjë me lëndën e regjistruar KPA17887.

Mbi bazën e këtyre rrethanave ankesa e P.I kundër të njëjtit vendim nuk ka interes juridik dhe ajo si e tillë duhet të hedhet. Kushtet që kanë të bëjnë me interesin ligjor qëndrojnë gjatë gjithë procedurës civile dhe janë të aplikueshme për çdo palë – arsyetimi sipas nenit 2.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Ligji parashikon që pala duhet të ketë interes ligjor në kërkesë dhe që të ndërmerren veprime të tjera procedurale.

Bazuar në nenin 196 të LPK-ës hedhet padia e B.M.

Mbi të mësipërmen, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitivin e aktgjykimit.

Ankuesi nuk duhet të paguaj taksën për ushtrimin e ankesës, meqë kjo papranueshmëri është rezultat i lëshimeve të Gjykatës për të bashkuar procedurat në lëndët 43/12 dhe 220/12.

Këshilla Ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Rregullorës së UNMIK-ut i amendamentuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është përfundimtar dhe i ekzekutueshëm dhe nuk mund të goditet përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, EULEX Gjyqtare Kryesuese

Willem Brouwer, EULEX Gjyqtar

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, EULEX Referent